



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3844/18 Prot.

Tiranë, më 18.12. 2024

VENDIM

Nr. 91 dt. 18.12 2024

“PËR

**KTHIMIN E DOSJES SË APLIKIMIT TË DOC. DR. ELTON BANO,
KANDIDAT PËR MARRJEN E TITUJVE AKADEMIK, I CILI NUK E KA
KALUAR FAZËN E MIRATIMIT NGA KOMISIONI I PROMOVIMIT TË
PERSONELIT AKADEMIK (KPPA)”**

Në zbatim të nenit 38, 60, 61 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Kreu IV pika 1,2, 3 dhe Kreun V pika 9/1 e V.K.M-së nr.112 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, nenit 20 të Statutit të UST-së, Nenit 13 të Rregullores së Veprimtarisë së Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së, kërkesës drejtuar Senatit Akademik të Doc.Dr Elton Bano me nr. 3876 Prot., datë 18.12.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.12.2024,

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës për kthimin e dosjes së Doc.Dr. Elton Bano, kandidat i cili ka filluar procedurën për marrjen e titujve akademikë dhe nuk e ka kaluar fazën e miratimit nga KPPA, me qëllim aplikimin sipas kërkesave të v.k.m-së nr.128, datë 6.3.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 112, datë 23.2.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore ‘doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘profesor i asociuar’ dhe ‘profesor’”, i ndryshuar.
2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Komisionit të Promovimit të të Personelit Akademik si dhe Drejtorisë së Zhvillimi të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

